


VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 OD LUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC NË EMËR TË POPULLIT



12. 01. 2018
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit Ibrahim Idrizi, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 1119-6/16, të dt. 28.12.2016, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPP-së, me dt. 21.02.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 1119-6/16, të dt. 28.12.2016 dhe kjo gjykatë jepë këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit [REDACTED] nga i ati [REDACTED] i lindur më [REDACTED], në [REDACTED], me vendbanim në Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] në [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 27.06.2016, rreth orës 02:25, në magjistralen Kaçanik- Prishtinë, te rreth rrotullimi në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “VW Vento”, ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit [REDACTED] në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, ashtu që ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe me pjesën e përparme të automjetit fillimisht godet anësoren e betonit në anën e djathtë të rrugës, pastaj godet një shenjë të komunikacionit dhe ndalet në parkingun e pompës së derivateve “Hib Petrol”, me ç’ rast pos dëmit material, lëndime të lehta trupore ka pësuar bashkudhëtarja e tij- e dëmtuara [REDACTED] dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të

kafazit të kraharorit, me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përsëhkruar në ekspertizën mjeko ligjore të datës 20.12.2016.

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 23, 41, 42, 43, 46, 73 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 365 të KPPK-së,

E G J Y K O N

ME DËNIM NË GJOBË NË SHUMË PREJ 200€ (dyqind euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgimi ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20€ dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20€, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për të realizuar kërkesën pasurore juridike e dëmtuara [REDAKTUAR] udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II. nr. 1119-6/16, të dt. 28.12.2016, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 të KPP-së.

Nga provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: raporti i policit me numër 2016-CFT-364 i dt. 27.06.2016, ekspertiza mjeko ligjore për natyrën e lëndimeve të të dëmtuarës e datës 20.12.2016, si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj Gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 e 453 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike bazohet në nenin 463 të KPPK-së, meqë të dhënat e mbledhura nuk paraqesin bazë të sigurte për gjykimin e plotë apo të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P. nr. 24/17

Më datë 21.02.2017

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari i vetëm gjykues



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj Gjykate përmes kësaj Gjykate. Në rast të vendosjes lidhur me kundërshtimin, Gjykata nuk detyrohet të veprojë sipas kërkesës së prokurorit për dënim me gjobë dhe as me ndalesën nga neni 395 i KPPK-së, që ka të bëjë me parimin "reformatio in peius- mos keqësimi i pozitës së të pandehurit në procedurë".